

STATUTI & AKT THEMLIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"LEDINA RESORT" SH.P.K

Neni 1

Emërtimi i shoqerise

Sot me date 25/08/2021 krijohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e quajtur "LEDINA RESORT" shpk nga ortakët:
Ganian Karteri i datelindjes 31/07/1985 me id I507310200 me pergjegjesi te plote e juridike per te vepruar
Pëllumb Karteri i datelindjes 07/04/1953 me id F30407100P me pergjegjesi te plote e juridike per te vepruar
Mamica Karteri e datelindjes 09/08/1955 me id F558090290 me pergjegjesi te plote e juridike per te vepruar
Shoqeria eshte person juridik dhe ushtron veprimtarine ne baze te Ligjit Nr.9901 ,date 14.04.2008" Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 2

Selia e shoqerise

Selia e shoqërisë "LEDINA RESORT" shpk është Vlore, Radhime, Rruga nacionale Vlore-orikum, Fshati Radhime, Objekt TIRANA RESORT 2010, Nr.111
Shoqëria mund të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj. Shoqëria sipas parashikimeve të këtij statuti dhe legjislacioni në fuqi, mund të hapë si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, qendra dhe përfaqësi apo filiale, degë dhe shoqëri të tjera.

Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarise

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin tregtar do te jete subjekt i te drejtes me nje afat te pacaktuar. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të ortakut të shoqerise.

Neni 4

Objekti

Objekti i shoqërisë do te jete si vijon :
Hotel

NENI 5

Kapitali i regjistruar

Vlera e kapitalit të kontribuar dhe i regjistruar në shoqëri është 800.000 leke (treqindemijë), numri i kuotave është 3 (tre) i zotëruar nga ortakët sipas kontributeve:
Mamica Karteri 1 kuote në masën 33% me vlerë 264000 leke
Ganian Karteri 1 kuote në masën 33% me vlerë 264000 leke
Pëllmb karteri 1 kuote në masën 34% me vlerë 272000 leke
Kapitali i shoqërisë mund të rritet apo të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së përgjithshme të shoqërisë.

Neni 6

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

Kuotat e kapitalit të shoqërisë "LEDINA RESORT" shpik e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
kontributit nëkapitalin e shoqërisë;
shitblerjes;
trashëgimisë;
dhurimit
çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj
Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
Kalimin e kuotave, veçanërisht miratohen në mbledhjen e asamblesë të shoqërisë ku të drejten e parablerjes e kanë ortakët e shoqërisë

Neni 7

Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë

Të drejtat dhe detyrimet

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesvedhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike; dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) çështjetë tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

3. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishtë pasur dijeni për të.

Neni 8

Mbledhja e asamblesë së përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji, nga ligjetë tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligji.

3. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

4. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

5. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.

7. Dispozitat e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohen nëse blerjet, sipas pikave 4 e 5 të këtij neni, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.

8. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

Neni 9

Mënyra e thirrjes

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi meshkresë ose, nëseparashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresëapo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve,jo më vonë se 7 ditëpërpara datës së parashikuarpër mbledhjen e asamblesë.
2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime tëvlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, përtë marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kërkesa nga ortakët e pakicës

1. Ortakët, të cilët përfaqësojnëpaktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuarnë statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrurasamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve tëposaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, përtë cilat asambleja duhet të marrë njëvendim. Nësekërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtëta thërrasin asamblenë dhetë caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të këtij ligji.
2. Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtijneni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuarprejkëtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën,ka të drejtë:
 - a) të ngrejëpadi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
 - b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.
3. Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij nenidhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar,në përputhje me parashikimet e pikës 1 të nenit 83 të këtijligji.
4. Përfaqësuesi iautorizuar është idetyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjenepërfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësua

Neni 11

Përfaqësiminë asamble

1. Ortaku mund të përfaqësohetnë asamblenëe përgjithshme, në bazë të një autoriziminga një ortak tjetër apo nga njëperson i tretë.
2. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 12

Kuorumi

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtëvotë, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kurasambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë meshkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsërijo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 13

Marrja e vendimeve

1. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tiritë katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të këtij ligji, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të këtij ligji, asambleja e përgjithshme vendos meshumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.
3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

Neni 14

E drejta e votës

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, çdo kuotë jep të drejtën e një vote.
2. Statuti mund të parashikojë për ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.
3. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:
 - a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
 - b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehin për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;

c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes sëmbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, përtë marrë pjesë fizikisht në mbledhje.

4. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë ekomunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyreqëllimeve.

5. Ortakët kanë të drejtën, qëu njihet nga ky ligj apo statuti, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

Neni 15

Përfashtimi nga e drejta e votes

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- c) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson

Neni 16

Procesverbalet e mbledhjes së asamblesë

1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbalevetë mbledhjevetë asamblesë së përgjithshme.

2. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin embledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit etë mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

3. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

4. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

5. Nëse shoqëria ka publikuar njëfaqe në internet, administratorët, jo më vonëse 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit tëmbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

Neni 17

Drejtimi dhe administrimit

Shoqeria tregtare "LEDINA RESORT" shpk do te drejtohet nga nje administrator qe emerohet me vendim te Asamblese te Shoqerise. Administratori i shoqerise per periudhen 5 vjecare duke filluar nga data e sotme do te jete ortaku Z. Pëllumb Karteri i datelindjes 07/04/1953 me id F30407100P. Administratori ka te drejte e te detyrohet te :

- Kryej te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politika tregtare te vendosur nga asamblea e përgjithshme e shoqerise.
- Perfaqesoje shoqerine tregtare
- Kujdeset per mbajtjen sakte e te regullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise
- Pergatit dhe nenshkruan bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe sebashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve ,I paraqet keto perpara asamblea e përgjithshme e shoqerise per miratim,
- Krijon nje system paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise,
- Kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme sic parashikohen ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit
- Raporton para asamblese te përgjithshme e shoqerise ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare,
- Administratori do te shperblehet sipas percaktimit te asamblese se përgjithshme te shoqerise ne perputhje me dispozitat ligjore te ligjit nr 9901 date 14.04.2008.

Neni 18

Kontrolli i brendshem

Shoqeria tregtare organizon kontrollin e brendshem me nje ekspert kontabel te regjistruar , i cil eshte pergjegjes perpara shoqerise per demet qe mund te shkaktoje nga moskryerja ne regull e detyres se tij

Neni 19

Bilancet dhe te ardhurat

Veprimet ekonomike e financiare te shoqerise do te mbyllen me 31 Dhjetor te cdo viti, pervec rasteve e urdherave te vecanta te ortakeve te shoqerise. Ne fund te cdo periudhe ushtrimore nxiret bilanci kontabel dhe rezultati ekonomik humbje/fitim. Bilanci kontabel miratohet brenda dates 31 Mars te viti paseardhes dhe pas pagimit te detyrimeve fiskale pjesa qe mbetet i jepet per perdorim asamblese se përgjithshme te shoqerise.

Neni 20

Shperberja e shoqerise

Shperberja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe cfardo shkaku. Ne rast shkrirje para afatit te shoqerise, Asamblea e pergjithshme e shoqerise vendos mbi menytrat e likujdimit dhe cakton nje ose me shume likujdator duke i percaktuar dhe detyrat. Ne rasti e likujdimit emertimi i shoqerise do te shoqerohet nga shenimi " shoqeri ne likujdim "

Administratoret regjistrojne prishjen e shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr 9723 date 03.05.2007 " Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit "

Neni 21

Dispozitat perfundimtare

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut do i referohet plotesimeve nga asamblea e pergjithshme e shoqerise.

Shoqeria "LEDINA RESORT" shpk do te jete subjekt i te drejtes shqiptare dhe do ushtroje aktivitetin e saj ne perputhje me normat e legjislacionit shqiptar ne pergjithesi ,normat e ketij statuti dhe te aktit themelues bashkangjitur .

Ky statut nenshkruhet nga ortakut i shoqerise ne daten 25 Gusht 2021

Ortaket

Pëllumb Karteri

Ganian Karteri

Mamica Karteri

